

VENDIM
Nr. 929, datë 17.11.2010

PËR KRIJIMIN DHE PËRDORIMIN E FONDIT TË VEÇANTË

(Ndryshuar me VKM nr. 493, datë 6.7.2011; nr. 826, datë 5.12.2011; nr. 849, datë 6.12.2012; nr. 905, datë 17.12.2014; nr. 915, datë 29.12.2014; nr. 234, datë 18.3.2015; nr. 991, datë 9.12.2015; nr. 818, datë 29.12.2017; nr. 821, datë 30.12.2017; nr. 813, datë 31.12.2018; nr. 781, datë 6.12.2019, nr. 1022, datë 16.12.2020, nr. 1044, datë 18.12.2020; nr. 801, datë 20.12.2021; nr. 859, datë 29.12.2021; nr. 871, datë 31.12.2021; nr. 809, datë 12.12.2022; nr. 728, datë 13.12.2023; nr. 767, datë 20.12.2023; 834, datë 28.12.2023)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 5/1 të ligjit nr. 8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondi i veçantë në njësitë e qeverisjes së përgjithshme krijohet në masën 5% të fondit të pagave. Fondi i pagave, për efekt të llogaritjes së fondit të veçantë, do të përfshijë vetëm fondin e pagave për numrin faktik organik të punonjësve buxhetorë. Në këtë fond nuk përfshihet fondi i pagave për punonjësit në listë pritjeje, me kontratë të përkohshme, për ushtarakët në reformë, për punonjësit në dispozicion, për pagesën e bashkëshortëve të ushtarakëve dhe atë të studentëve ushtarakë.

2. Fondi i veçantë, i përlogaritur sipas pikës 1, përdoret nga drejtuesit e njësive të qeverisjes së përgjithshme për:

- a) shpërblimin e punonjësve për rezultate të mira në punë;
- b) shpërblimin e punonjësve në fund të vitit kalendarik;
- c) shpërblime të tjera, të parashikuara me akte të tjera ligjore apo nënligjore;
- ç) dhënie ndihmash të menjëhershme për raste fatkeqësish dhe për raste të tjera;
- d) veprimtari social-kulturore.

Formula e llogaritjes së fondit të veçantë faktik, për t’u përdorur, përcaktohet në ankesin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Shpërblimi për rezultate të mira në punë gjatë vitit, për çdo punonjës, jepet i diferencuar nga drejtuesi i njësisë së qeverisjes së përgjithshme, por jo më shumë se 1 (një) pagë mujore në vit. Ky shpërblim, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të cilat janë në fushën e veprimit të ligjit të shërbimit civil, jepet i diferencuar në bazë të rezultateve individuale në punë, sipas parimeve dhe procedurës së përcaktuar në legjislacionin e shërbimit civil dhe në përputhje me fondin e shpërblimit në dispozicion. Gjithashtu, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të cilat nuk përfshihen në fushën e veprimit të ligjit të shërbimit civil, shpërblimi i punonjësve bëhet i diferencuar, në bazë të performancës së punonjësit, por jo më shumë se 1 (një) pagë mujore në vit. Shpërblimi i titullarit të njësisë së qeverisjes së përgjithshme dhe fondeve speciale, bëhet pas miratimit të eprorit të tij ose pas miratimit të organeve kolegjiale, për ato njësi që funksionojnë me drejtim kolegjial. Ky shpërblim jepet vetëm në muajin dhjetor të vitit aktual.

4. Shfuqizuar.

5. Edhe në rastet kur, sipas ligjeve të veçanta, lindin të drejta specifike të shpërblimit të punonjësve, ky shpërblim përballohet nga fondi i veçantë, i përlogaritur sipas pikës 1 të këtij

vendimi. Ky rregull nuk zbatohet vetëm kur në ligjin përkatës janë parashikuar burime të tjera specifike, të ndryshme nga fondi i veçantë. Në këto raste specifike shpërblimi jepet pas miratimit, nga titullari i institucionit qendror përkatës, të një udhëzimi, në të cilin parashikohen rregullat dhe kriteret e përfitimit të shpërblimeve mbi një pagë mujore.

6. Shpërblimi në fund të vitit i jepet çdo punonjësi buxhetor, për festat e fundvitit, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë, pavarësisht shpërblimit sipas pikës 3 të këtij vendimi, dhe përballohet nga fondi faktik i veçantë.

7. Në ndihma të menjëhershme për raste fatkeqësish dhe raste të tjera, të cilat përballohen nga fondi faktik i veçantë, përfshihen pagesat për rastet e:

- vdekjes së punonjësit të institucionit. Pagesa i jepet familjes së punonjësit nga titullari i institucionit në masën e një page mujore, por jo më pak se 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

- vdekjes së një anëtarit të familjes së punonjësit (bashkëshorti/ja, prindërit apo fëmijët). Pagesa jepet nga titullari i institucionit deri në 30 000 (tridhjetë mijë) lekë, për çdo rast;

- sëmundjeve të rënda të punonjësit, kur kërkohet një ndërhyrje kirurgjikale apo një trajtim mjekësor i gjatë. Pagesa jepet nga titullari i institucionit deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, për çdo rast;

- daljes së punonjësve në pension pleqërie. Pagesa jepet nga titullari i institucionit deri në masën e një page mujore.

Edhe në rastet kur, sipas ligjeve të veçanta, linden të drejta specifike të dhënies së ndihmave të menjëhershme, masa e ndihmës së dhënë përballohet nga fondi i veçantë, i përlogaritur sipas pikës 1 të këtij vendimi. Në këto raste specifike, masa e ndihmës jepet pas miratimit nga titullari i institucionit qendror përkatës nëpërmjet një udhëzimi, në të cilin parashikohen rregullat dhe kriteret e përfitimit të këtyre ndihmave.

8. Në veprimtari me karakter social apo kulturor, që përballohen nga fondi i veçantë, përfshihen ato veprimtari të cilat organizohen vetëm për punonjësit e institucionit, sikurse janë ato të organizuara për rastet e daljeve në pension, të festimeve të fundvitit dhe të tjera organizime të realizuara nga institucioni. Në çdo rast, masa e shpenzimit, që mbulohet nga fondi i veçantë për këto veprimtari, nuk duhet të kalojë vlerën e 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë për punonjës.

Kur veprimtari të social-kulturore organizohen jashtë qendrës së punës, shpenzimet e transportit dhe të akomodimit paguhen nga vetë punonjësit.

9. Për vitin 2023, fondi i veçantë i institucioneve qendrore buxhetore dhe jobuxhetore, institucioneve të vetëqeverisjes vendore, njësitë të fondeve speciale, institucioneve publike të krijuara me ligj të posaçëm, ndërmarrjeve me kapital mbi 50% shtetëror, në varësi të institucioneve qendrore dhe vetëqeverisjes vendore nuk përdoret për veprimtari social-kulturore dhe shpërblimin e punonjësve. Ky përcaktim nuk zbatohet, për:

- a) punonjësit mbështetës dhe punonjësit e tjerë të specialiteteve të ndryshme, të cilët paguhen me sistemin me 9 dhe 13 klasa, organikë dhe me kontratë të përkohshme mbi 6 muaj, në njësitë e qeverisjes qendrore, të cilët shpërblehen në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë;

- b) punonjësit e Policisë së Burgjeve, si dhe punonjësit e tjerë civilë të sistemit të burgjeve, përfshirë edhe punonjësit e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve, për të cilët masa e shpërblimit nuk tejkalon nivelin e një page mujore;

- c) punonjësit e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, të cilët shpërblehen deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

- ç) punonjësit e institucioneve të rivlerësimit kalimtar;

- d) 539 (pesëqind e tridhjetë e nëntë) pjesëtarë të Forcave të Armatosura që shpërblehen me 1 (një) pagë mujore dhe 38 (tridhjetë e tetë) pjesëtarë të Forcave të Armatosura, Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile e 7 (shtatë) personel zjarrfikës nga pushteti vendor në qytetet Korçë e Devoll që shpërblehen me 2 (dy) paga mujore;

- dh) 1 255 (një mijë e dyqind e pesëdhjetë e pesë) punonjës, personel zjarrfikës i pushtetit vendor, angazhuar në shuarjen e zjarreve për vitin 2023, që shpërblehen me 1 (një) pagë mujore, sipas listës për çdo bashki, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

10. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi përballohen nga buxheti vjetor, i miratuar për çdo institucion.

11. Vendimi nr.1151, datë 25.11.2009 i Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, shfuqizohet.

12. Ngarkohen njësitë e qeverisjes së përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI 1
PËRLLOGARITJA E FONDIT FAKTIK TË VEÇANTË PËR T'U PËRDORUR

Fondi i veçantë faktik për t'u përdorur = Fondi i pagave i punonjësve faktik organik për muajt më të fundit (p.sh. fondi faktik i numrit organik 11-mujor) + (shtohet) fondi i pagave i planifikuar për numrin faktik organik për muajin (muajt) e mbetur *5% - (zbriten) përdorimet e fondit të veçantë gjatë vitit aktual.

STRUKTURAT E MZSH-SË QË JANË ANGAZHUAR NË ZJARRE

Bashkia/DPMZSH	Nr Personeli	Fondi / lekë
DPMZSH	9	615,000
KORÇË	30	1,980,000
DEVOLL	14	940,000
KOLONJË	16	1,070,000
MALIQ	14	940,000
PUSTEC	14	940,000
POGRADEC	18	1,200,000
ELBASAN	25	1,655,000
GRAMSH	16	1,070,000
LIBRAZHD	15	1,005,000
PRRENJAS	14	940,000
PEQIN	14	940,000
CËRRIK	13	875,000
BELSH	12	810,000
DURRËS	44	2,890,000
KRUJË	13	875,000
SHIJAK	18	1,200,000
TIRANË	166	10,820,000
VORË	19	1,265,000
KAVAJË	17	1,135,000
RROGOZHINË	14	940,000
KAMËZ	46	3,020,000
SHKODËR	35	2,305,000
PUKË	15	1,005,000
VAU DEJËS	17	1,135,000
MALËSI E MADHE	20	1,330,000
FUSHË ARRËZ	17	1,135,000
LEZHË	36	2,370,000
MIRDITË	16	1,070,000
KURBIN	17	1,135,000
DIBËR	19	1,265,000
MAT	14	940,000
BULQIZË	12	810,000
KLOS	13	875,000
KUKËS	23	1,525,000
KALIMASH	16	1,070,000
HAS	14	940,000
TROPOJË	16	1,070,000
GJIROKASTËR	25	1,655,000
DROPULL	14	940,000
LIBOHOVË	15	1,005,000
PËRMET	13	875,000
KËLCYRË	14	940,000
MEMALIAJ	10	680,000
BERAT	30	1,980,000
SKRAPAR	15	1,005,000
POLIÇAN	14	940,000
KUÇOVË	14	940,000
DIMAL	17	1,135,000
FIER	29	1,915,000
PATOS	14	940,000
DIVJAKË	13	875,000
ROSKOVEC	13	875,000
MALLAKASTËR	12	810,000
LUSHNJË	14	940,000
VLORË	30	1,980,000
SARANDË	13	875,000
SELENICË	17	1,135,000
KONISPOL	14	940,000
HIMARË	14	940,000
FINIQ	16	1,070,000
DELVINË	14	940,000
TOTALI	1255	83,435,000